***GRADECI SHPK-SHENIMET SHPJEGUESE VITI 2020***

# Shenime per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2020

*(Te gjitha balancat jane ne leke)*

## 1. Informacione te pergjitheshme

"Gradeci" sh.p.k, eshte themeluar si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me 14/01/2016. Kapitali rregjistruar eshte 37,923,910lek dhe zoterohet nga ortaku themelues, Z.Ergis Guri me nga 100% .
Veprimtaria kryesore tregtare e shoqerise per ushtrimin 2020 Aktivitet ne Fushen tregtimit te karburanteve,etj.

## 2. Permbledhje e politikave kontabel

### Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë pergatitur në përputhje me ligjin shqiptar 'Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato jane pergatitur mbi bazen e parimit te kostos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit te te drejtave te kostatuara. Ato paraqiten ne monedhen vendase, Lekë Shqiptar ("lekë).

*Ne paraqitjen e pasqyrave financiare te vitit 2020 eshte zbatuar formati i SKK-2 dhe per rrjedhim zerat e pasqyrave financiare te periudhes krahasuese 2019 jane klasifikuar ne pershtatje me formatin e ri, e per rrjedhoje ato jane te krahasueshme.*

### *Parimet kontabile më domethënëse që janë përdorur nga shoqeria, janë si më poshtë:*

**Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve**

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara.Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri te mjaftushme ne marrjen e perfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përllogaritet me besueshmëri.Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atehere kur ato sigurohen prej te treteve dhe ne te njejtin ushtrim kontabel me te ardhurat e lidhura.

**Monedhat e huaja**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci,zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqeria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2020 jane 1 euro=123.7 leke dhe 1 dollar= 100.64leke.

**Tatimin mbi fitimin**

Shpenzimi per tatimin mbi fitimin perfaqson shumen e tatimit per tu paguar per vitin ushtrimor.Tatim fitimi i pagueshem per vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregetar qe raportohet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin per ushtrimin 2020 eshte 15 % e ndryshme nga norma qe ka qene ne ushtrimin e mëparshëm.

**Kërkesat për t'u arkëtuar**

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parà regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet përshembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

GRADECI sh.p.k.

**Pasivet financiare**

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parà, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

**Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara**

Aktivet afatgjata materiale(AAM-të) bazohen ne modelin e kostos. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Në se vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi eshte llogaritur mbi bazen e metodes lineare per ndertesat dhe mbi bazen e vleren se mbetur per pjesen tjeter te aktiveve te qendrueshme.

**Gjendjet e inventaret**

Vleresimi ne hyrje i inventareve behet me cmimet e blerjes dhe ne rastet kur eshte e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara per te sjelle inventaret ne kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit ne pasqyrat financiaret paraqiten me kostot e blerjeve te fundit te ushtrimitt qe nga drejtimi eshte çmuar si vlera neto te realizueshme.

## 3. Shenime per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2020

*(Te gjitha balancat jane ne leke)*

**Aktive monetare (likujditete në arke dhe bankë)**

Gjendjet e mjetet monetare ne banke dhe arke, ne leke dhe valute, ne datat 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 jane si me poshte:

| | Aktivet monetare | 1 | Viti ushtrimor 31.12.2020 | Viti ushtrimor 31.12.2019 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Banka | | 186,183 | 4,138,689 |
| 2 | Arka | | 621,830 | 653,109 |
| | **Totali** | | **808,013** | **4,791,798** |

Gjendjet e llogarive te likujditeteve te paraqitura ne pasqyrat financiare jane te njejta me te dhenat e kontabilitetit rrjedhes dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj jane përkthyer ne leke duke përdorur kursin zyrtar te këmbimit ne daten 31.12.2020.

**Te drejta te arketueshme**

Te drejta te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit, ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2020 deklarohen si vijon:

| | Të drejta të arkëtueshme-Nga aktiviteti i shfrytëzimit | 3.1 | Viti ushtrimor 31.12.2020 | Viti ushtrimor 31.12.2019 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Kliente te parketuar | | 47,131,503 | 48,640,120 |
| | **Totali** | | **47,131,503** | **48,640,120** |

GRADECI Sh.p.k. SHQIPERISE Nuis: L68714401S Albania

## *GRADECI SHPK-SHENIMET SHPJEGUESE VITI 2020*

Ne "Te drejta te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit " jane pasqyruar faturat e papaguara per shitje mallrash dhe sherbimesh qe shoqeria ka realizuar gjate veprimtarise se saj ne shumen 47,131,503. Ne kete shume jane perfshire kerkesat per arketim afatgjate dhe afatshkurtra .

Drejtimi mendon se te gjitha kerkesat do te arketohen me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon renie ne vlere.

Kerkesat per arketim sipas drejtimit do te arketohen brenda periudhes qe jane klasifikuar.Pervec fakteve te paparashikuara kur nuk zbatohet kontrata.

**Te drejta te arketueshme- te Tjera**

Ne "Te drejta te arketueshme te tjera" jane perfshire te gjitha te drejtat tatimore ne dt. 31/12/2019,te cilat duhet te arketohen ne vitin 2020si dhe huate e marra.

| | Të drejta të arkëtueshme-Të tjera | 3.4 | Viti ushtrimor 31.12.2020 | Viti ushtrimor 31.12.2019 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Tvsh kreditore /Sigurime shoqerore | | 0 | 46,035 |
| 2 | Hua ortaku | | 57,431,063 | 31,560,450 |
| 3 | Tatim fitimi | | 0 | 0 |
| 4 | Debitore te tjere | | 19,926,074 | 19,644,155 |
| | **Totali** | | **77,357,137** | **51,250,640** |

Debitore te tjere eshte huaja qe shoqerise i detyrohen me 31.12.2020 si me poshte:

Brati shpk 170,000lek

Hajli Sojati 173,400lek

BIO Skrapari 19,582,673lek

**Inventari**

Ne llogari Inventare jane perfshire :

| | Inventarët | 4 | Viti ushtrimor 31.12.2020 | Viti ushtrimor 31.12.2019 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Mallra | 4.4 | 6,195,067 | 2,338,348 |
| 2 | Parapagime per inventare | 4.7 | 52,000 | 11,683 |
| | **Totali** | | **6,247,067** | **2,338,348** |

Vlerat e inventarit te paraqitura me siper perputhen me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike e kryer ne fund te ushtrimit 2020. Veprimet ekonomike qe lidhen me hyrjet e daljet jane tranzituar ne llogarite e rezultatit me menyren e inventarit te perhershem. Si politike kontabel ne percaktimin e kostos se inventarit eshte perdorur metoda "mesatares se ponderuar".

**Aktivet Afatgjata Materiale(AAM-te)**

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjata materiale ne pasqyrat financiare paraqitet si vijon:

Sh.p.k. Nuis: L63714401S Albania

*GRADECI SHPK-SHENIMET SHPJEGUESE VITI 2020*

| Aktivet materiale | | 8 | Vlera Fillestare | Amortizimi I akumuluar | Vlera e mbetur |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Toka | 8.1 | 8,676,000 | | 8,676,000 |
| 2 | Ndërtesa | 8.1 | 8,836,000 | 1,650,774 | 7,185,226 |
| 3 | Impiante dhe makineri | 8.2 | 16,455,190 | 7,316,471 | 9,138,719 |
| 4 | Mjete Transporti | 8.3 | 2,876,009 | 1,277,939 | 1,598,070 |
| 5 | Te tjera aktive | 8.4 | 1,116,147 | 631,570 | 484,577 |
| | **Totali** | | **37,959,346** | **10,876,754** | **27,082,592** |

Vlerat dhe klasifikimi ne grupe i AAM-ve te pasqyruara ne bilanc dhe ne tabelen e mesiperme jane te perputhura me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike qe shoqeria e ka kryer ne fund te muajit dhjetor 2020. Si politike kontabel per kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e kostos (SKK-5).Vleresimi fillestar ne momentin e marrjes ne inventar eshte bere me koston e marrjes dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.

**Detyrime afatshkurtera-Te Pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit**

"Të pagueshme ndaj furnitorëve" pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve per blerjen e mallrave e pa u likujduar ne fund te ushtrimit.

| Detyrime afatshkurtra-Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit | | 13.4 | Viti ushtrimor 31.12.2020 | Viti ushtrimor 31.12.2019 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Furnitore te papaguar | | 43,759,617 | 33,672,349 |
| 2 | Arketime ne avance per porosi | | 823,067 | 1,115,229 |
| | **Totali** | | **44,582,684** | **33,672,349** |

Shoqeria ka pergatitur inventaret kontabel dhe shuma e llogarise sintetike eshte e barabarte me shumen e llogarive analitike te mbajtura per cdo furnitor.Drejtimi mendon se gjendja e furnitoreve eshte reale . Tepricat e shprehura në monedhë të huaj jane përkthyer ne leke duke përdorur kursin zyrtar te këmbimit ne daten 31.12.2020. Te pagueshme ndaj furnitoreve deri ne date 31/12/2020 ne shumen 44,582,684leke.

Arketime ne avance per porosi paraqet pagesat e klienteve per furnizime,te cilat do realizohen ne vitin 2021:

- Parapagim Seman 2 Sun 823,067lek .

**Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetsore**

"Të pagueshme ndaj punonjesve" pasqyron detyrimet ndaj punonjsve per pagat pa u likujduar ne fund te periudhes se ushtrimit.

| Detyrime afatshkurtra-Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore | | 13.8 | Viti ushtrimor 31.12.2020 | Viti ushtrimor 31.12.2019 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Paga personeli | | 595,938 | 63,778 |
| 2 | Detyrim Sigurime shoqerore dhe shendetesore | | 14,229 | 0 |
| | **Totali** | | **610,167** | **63,778** |

Keto detyrime jane detyrimet qe paguhen ne janar 2021.

**Te pagueshme per detyrimet tatimore**

"Të pagueshme per detyrimet tatimore" pasqyron detyrimet organit tatimor pa u likujduar ne fund te periudhes se ushtrimit

REPUBLIKA E SHQIPERISE GRADECI Sh.p.k Nuis : L68714401S Corovode - Skrapar - Albania

| Detyrime afatshkurtra-Të pagueshme për detyrimet tatimore | | 13.9 | Viti ushtrimor 31.12.2020 | Viti ushtrimor 31.12.2019 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | TVSH | | 54,710 | 1,156,442 |
| 2 | Tatim fitimi | | 4,935,624 | 5,100,142 |
| | **Totali** | | **4,990,334** | **6,256,584** |

Keto detyrime jane detyrimet qe paguhen ne janar 2021.

**Detyrime afatshkurta -Detyrime ndaj institucioneve te kredise**

| Detyrime afatshkurtra-Të tjera të pagueshme | | 13.1 | Viti ushtrimor 31.12.2020 | Viti ushtrimor 31.12.2019 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Detyrime ndaj institucioneve të kredisë | | 4,284,186 | 0 |
| 2 | Te tjera te pagueshme | | 924,752 | |
| | **Totali** | | **5,208,938** | 0 |

Ne kete tabele jane perfshire te gjitha huat nga bankat, llogarite analitike ne leke dhe ne monedha te tjera kuadrojne me llogarite sintetike. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj jane përkthyer ne leke duke përdorur kursin e këmbimit te Bankes se Shqiperise ne dt 31.12.2020.Ato jane te verifikuara me planin e amortizimit I cili eshte ne dispozicion te shoqerise:

- Credins Bank Overdraft 4,284,186lek.

**Detyrime afatgjata -Detyrime ndaj institucioneve te kredise**

| Detyrime afatgjata-Detyrime ndaj institucioneve të kredisë | | 17.2 | Viti ushtrimor 31.12.2020 | Viti ushtrimor 31.12.2019 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Hua Bankare | | 55,403,019 | 56,048,763 |
| 2 | Debitore te tjere | | 0 | 0 |
| | **Totali** | | **55,403,019** | **56,048,763** |

Ne kete tabele jane perfshire te gjitha huat nga bankat, llogarite analitike ne leke dhe ne monedha te tjera kuadrojne me llogarite sintetike. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj jane përkthyer ne leke duke përdorur kursin e këmbimit te Bankes se Shqiperise ne dt 31.12.2020.Ato jane te verifikuara me planin e amortizimit I cili eshte ne dispozicion te shoqerise:

- Fondi Besa 447,882 Euro

**Kapitalet e veta**

Kapitali i rregjistruar i shoqerise, i paraqitur ne bilanc pergjate vitit 2020 ka ndryshuar ( i cili eshte 37,923,910 lek i zmadhuar pergjate vitit 2020 me Vendim Asambleje dhe Raport te Audituesit Ligjore).

**Fitimi/humbja e vitit financiar**

**Te ardhuara nga aktiviteti i shfrytezimit**

Te ardhurat e shoqerise jane klasifikuar per efekt menaxhimi ne shume nenllogari te cilat bejne te mundur analizen e sakte ekonomike financiare lista e tyre paraqitet si me poshte:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË GRADECI Sh.p.k. Nuis: L68714401S Çorovode - Skrapar - Albania

| Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit | | 29 | Viti ushtrimor 31.12.2020 | Viti ushtrimor 31.12.2019 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Te ardhura nga shitja e mallrave | | 47,357,778 | 42,371,576 |
| | **Totali** | | **47,357,778** | **42,371,576** |

**Te ardhura te tjera shfrytezimi**

| Të ardhura të tjera të shfrytëzimit | | 32 | Viti ushtrimor 31.12.2020 | Viti ushtrimor 31.12.2019 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Te ardhura nga qeraja | | 9,575,921 | 54,525,817 |
| 2 | Te ardhura nga sherbimet | | 2,816,333 | 287,283 |
| 3 | Te ardhura te tjera | | 0 | 392,631 |
| | **Totali** | | **12,392,254** | **55,205,731** |

**Materialet e konsumuara**

Shuma e mesiperme eshte kosto e mallrave te shitura gjate vitit ushtrimor 2020. Ne kete post jane perfshire te gjitha kostot e produkteve te mallrave te te shitura gjate periudhes ushtrimore .

| Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme | | 33 | Viti ushtrimor 31.12.2020 | Viti ushtrimor 31.12.2019 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme | 33.1 | 39,293,211 | 37,084,375 |
| | **Totali** | | 39,293,211 | 37,084,375 |

**Shpenzime personeli**

Shoqeria ka marre ne pune dhe ka paguar punonjesit e saj konform dispozitave ligjore. Per ata jane paguar kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore dhe jane bere ndalesat per keto kontribute si dhe per tatimin mbi te ardhurat nga punesimi rregullisht.

| Shpenzime të personelit | | 34 | Viti ushtrimor 31.12.2020 | Viti ushtrimor 31.12.2019 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Paga dhe shpërblime | 34.1 | 980,000 | 1,179,000 |
| 2 | Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pensionet) | 34.2 | 163,660 | 196,893 |
| | ***Totali*** | | **1,143,660** | **1,375,893** |

Ne koston e punes nuk jane perfshire trajtimet shperblimet dhe dietat e punonjeseve.Numri mesatar i punonjesve gjate vitit 2020 ka qene 3(tre)punonjes.

**Shpenzime te tjera shfrytezimi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË GRADECI Sh.p.k. Nuis: L68714401S Çorovode - Skrapar - Albania

| | Shpenzime të tjera shfrytëzimi | 37 | Viti ushtrimor 31.12.2020 | Viti ushtrimor 31.12.2019 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Blerje Energji, avull, uje | | 373,028 | 94,236 |
| 2 | Blerje karburant | | 960,416 | |
| 3 | Sigurime | | 12,240 | 124,055 |
| 4 | Shpenzime te tjera | | 14,638 | 17,667 |
| 5 | Qera per mjetet | | - | 11,632,326 |
| 6 | Mirembajtje dhe riparime | | 1,136,573 | 299,347 |
| 7 | Shpenzime per kasen fiskale | | | |
| 8 | Shpenzime per IQT | | | 6,667 |
| 9 | Licensa e naftes dhe certifikimi I pistoletave | | 176,000 | 200,000 |
| 10 | Shpenzime per rivleresime kolaterali | | | |
| 11 | Sherbime te ndryshme | | 250,000 | 262,000 |
| 12 | Shpenzime telefoni | | 16,670 | 15,003 |
| 13 | Certifikimi ISO | | | 300,528 |
| 14 | Sherbime bankare | | 141,723 | 59,842 |
| 15 | Tatime te ndryshme | | 4,300 | 3,615 |
| 16 | Te tjera tatim taksa vendore | | 78,676 | 64,000 |
| 17 | Penalitete gjoba | | 132,028 | 206,036 |
| | **Totali** | | **3,296,293** | **13,285,322** |

Ne llogarine shpenzime te tjera jane perfshire edhe shpenzimet e pa njohura fiskalisht.

**<u>Te ardhurat dhe shpenzimet financiare</u>**

Jane paraqitur si diference e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standarteve.Ato paraqiten sipas zerave te te ardhura dhe shpenzimeve financiare si me poshte

| Të ardhura të tjera -Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme | | 38.3 | Viti ushtrimor 31.12.2020 | Viti ushtrimor 31.12.2019 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Te ardhura nga konvertimi | | 20,578 | 586,445 |
| 2 | Te ardhura nga interesi | | 0 | 0 |
| | | | **20,578** | **586,445** |
| | | | | |
| **Shpenzime financiare** | | 40 | Viti ushtrimor 31.12.2020 | Viti ushtrimor 31.12.2019 |
| | Te ardhura nga interesat | 40.1 | 0 | 0 |
| | Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme | 40.2 | 2,653,975 | 7,145,244 |
| | Shpenzime të tjera financiare-Humbje nga Konvertimi | 40.3 | 772,116 | 11,504 |
| | | | **3,426,091** | **7,156,748** |

**<u>Fitimi i ushtrimit dhe tatimi mbi fitimin</u>**

Shpenzimet e tatimi mbi fitimin per ushtrimin kontabel 2020 dhe 2019 jane si vijon:

REPUBLIKA E SHQIPERISE GRADECI Sh.p.k. Nuis: L68714401S Çorovodë - Skrapar - Albania

*GRADECI SHPK-SHENIMET SHPJEGUESE VITI 2020*

| FITIMI I USHTRIMIT | | Viti ushtrimor 31.12.2020 | Viti ushtrimor 31.12.2019 |
|---|---|---|---|
| Fitimi I ushtrimi | | 9,475,456 | 36,414,066 |
| Shpenzime te pannjohura | | - | - |
| Gjoba penalitetti | | 132,028 | 206,036 |
| **Fitimi fiskal** | | **9,607,485** | **36,620,102** |
| Tatim fitim | | 1,441,123 | 5,493,015 |
| **Fitimi neto** | | **8,034,334** | **30,921,051** |

Tatim fitimi i ushtrimit eshte i llogaritur mbi fitimin e tatushem duke mare ne konsiderate dhe shpenzimet e panjohura fiskalisht.

**Transaksione te paleve te lidhura**

Ne marrjen ne konsiderate te çdo transaksione dhe marredhenie te mundeshme, jo thjesht formen ligjore te tyre , veç huase se marre nga ortaku nuk ka transaksione te tjera me palet e lidhura.

**Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit**

Asnje ngjarje e rendesishme nuk ka ndodhur pas dates se miratimit te pasqyrave financiare.Nga analiza e gjendjes dhe performances financiare te shoqerise, rezulton se ne ushtrimin 2020 eshte ulur shifra e afarizmit .

**Shifrat krahasuese**

Shifrat krahasuese te deklaruara ne pasqyrat financiare 2020 jane te krahasueshme me ato te pasqyrave financiare te ushtrimit 2020.

**ADMINISTRATORI**

ERGIS GURI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË GRADECI Sh.p.K. Nuis : L68714401S Çorovode - Skrapar - Albania